

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigorisë kibernetike”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektvendimi “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigorisë kibernetike” **nuk është publikuar në RENJK**, por janë zhvilluar takime konsultative në Autoritet në data 4-5 Qershor 2025, me grupet e interesit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Lidhur me projektvendimin "Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigorisë kibernetike", nga ana e Autoritetit në datën 27.05.2025 Autoriteti publikoi për konsultim në faqen zyrtare të tij (www.aks.gov.al). Gjithashtu Autoriteti në datat 4 dhe 5 Qershor 2025, organizoi në ambientet e AKSK takime konsultative lidhur me projektvendimin, ku morën pjesë përfaqësues nga infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit (duke përfshirë BSH, banka të nivelit të dytë, AKSHI, MIE, OST etj), kompani që ofrojnë, prodhojnë produkte dhe shërbime TIK, ekspertë të pavarur, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit dhe përfaqësues të Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut si subjekte përgjegjëse për zbatimin e këtij projektvendimi.

Grupet e interesit u njoftuan nga AKSK në formë shkresore, përkatësisht me shkresat nr. 1955 prot, datë 30.05.2025, shkresës nr. 1956 prot, datë 30.05.2026 “Ftesë për pjesëmarrje në konsultimin publik të projektvendimit të skemës kombëtare të certifikimit të sigorisë kibernetike” si dhe nëpërmjet emailit.

Qëllimi kryesor i këtyre takimeve ishte prezantimi dhe njohja me projektvendimin “Për miratimin e Skemës Kombëtare të Certifikimit të Sigorisë Kibernetike” nga ana e pjesëmarrësve si dhe dhënia e komenteve dhe sugjerimeve nga ana e tyre. Vlen të theksohet se nga ana e Autoritetit janë marrë në konsideratë pjesa më e madhe e komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nga DPA.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektvendimi është propozuar nga Kryeministri dhe është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK). Gjithashtu AKSK është konsultuar lidhur me projektvendimin me ekspert nga CILC: Center for International Legal Cooperation.

Gjatë takimeve konsultative të zhvilluara në datat 4-5 Qershor 2025 institucionet të cilat kanë përcjellë komente dhe sugjerime (elektronikisht) janë si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
Lidhur me përkufizimet	DALLIMET MIDIS (ITSEF) DHE OVK Aspekti ITSEF (Information Technology Security Evaluation Facility) Funksioni Laborator teknik që bën vlerësimin teknik dhe testimin e produktit. Akreditimi I akredituar si laborator CAB (Organ Vlerësimi i Konformitetit) Institucioni që mbikëqyr procesin e certifikimit dhe lëshon certifikatën. I akredituar si organ	DPA	Pranuar	

	testimi (sipas ISO/IEC 17025). raportin teknik të vlerësimit (ETR). Nuk është domosdoshmërisht përgjegjës për certifikim – i raportojnë CAB-it ose autoritetit. Fusha e ekspertizës Vlerësim teknik i thelluar i sigurisë (penetrim, analizë, testim). Dallimet midis Autoritetit Kombëtar dhe OVK Konkluzion:. Neni 2 “Perkufizime” Sugjerimet të behen riformulohen: “Certifikata” si vijon: “është një certifikatë sigurie kibernetike e lëshuar sipas skemes së certifikimit të sigurisë kibernetike për produktet TIK....”.Për sqarim thjesht perkufizimit i shtohet togfjalëshi ne “bold”. "Organ certifikues" dhe "Organi i vlerësimit të sigurisë së teknologjisë së informacionit (ITSEF)" duhen riformuluar posacerisht sipas perkufizimit të dhënë në rregulloren në fjalë. Në kontekst të rregullores 482/2024 dhe dokumentacionit teknik të skemës EUCC, nuk është detyrë e trupave			
	certifikimi (sipas ISO/IEC 17065). Përdor raportin e ITSEF për të marrë vendimin për certifikim. Raporton të autoriteti kombëtar i certifikimit (p.sh. BSI, ANSSI). Menaxhimi i konformitetit dhe certifikimit ligjor/administrativ.			

	certifikuese te bejne testim te drejtperdrejta, dhe as inspektime teknike te thelluara. Ato nuk kryejne aktivite testimi, inspektimi, kalibrimi por mbeshteten ne raportet e ITSEF. Gjithashtu ITSEF nuk mund te kryejne aktivite certifikimi. Ndaj dhe si rezultat jam e mendimit qe Perkufizimi i dhene per “Organ certifikues” si dhe “Organ i vlersimit te sigurise” se teknologjise se informacionit (ITSEF) jane shprehur gabim dhe duhen riformuluar. Sugjeroj qe riformulimi te lihet posacerisht sic eshte shprehur per te dyja keto terminologji ne Rregulloren Europiane 482/2024			
Neni 3 “Standartet e Vlersimit”	- Pika 2, germa a), standartet e cituar ne kete fjali jane dhene ne menyre kumulative apo alternative? Ne varesi te qellimit sugjerojme te behet rregullimi perkates me qellim qe te jete me e qarte menyra e implementimit.	DPA	Pranuar	
	- Pika 3, sugjeroj te riformulohet “Nje certificate e leshuar ne perputhje me standartet e permendura ne piken 1 te ketij neni, konsiderohet e leshuar sipas skemes dhe prezumon konformitet me nje profil te mbrojtjes qe permbush standartet e listuara ne pik[n 2 te ketij neni.	DPA	Pranuar	

	- Pika 4, te riformulohet ne menyre te ngjashme me pike 3 per ate pjese ku eshte dhene sugjerimi per riformulim	DPA	Pranuar	
Neni 5 “Metodat e certifikimit te produteve TIK”	- Pika 1, germa b) duhet riformuluar si vijon: “duke perfshire nje profil te mbrojtjes si pjese e procesit TIK....”	DPA	Pranuar	
Neni 7 “Kriteret dhe metodat e vlersimit per produktet TIK”	- Pika 1, germa ç, togfjaleshi “dokumentet e aplikimit” te zevendesohet sipas perkufizimit te dhene ne Nenin 2, “dokument Teknik me i fundit”	DPA	Pranuar	
Neni 9 “Informacion i I nevojshem per certifikim dhe vleresim”	- Ne piken 3 dhe 4 duhet bere riformulimi korrekt ne lidhje me ofrimin e rezultateve te meparshme te certifikimit nga aplikantet dhe riperdorimin e tyre nga ITSEF. Sipas rregullores 482 ky veprim eshte I mundshem (lejohet) por jo I detyrueshem. Ndaj ne kontekst te rregullores sugjeroj riformulimin e ketyre	DPA	Pranuar	

	neneve me qellim qe te mos e percaktoj si detyrim percaktim por si nje mundesi.			
Neni 13 “Marka dhe etiketa”	- Pika 1, e percakton vendosjen e markes si detyrim, nderkohe rregullorja e percakton si kriter fleksibel duke perdorur togfjaleshin “may affix a mark and label” ç’ka e ben kete parashikim opsional. Nuk mendoj se skema EUCC e ka kriter te detyrueshem dhe absolut vendosjen e markes. - Pika 4, germa ç) vendoset si kriter absolut, nderkoh rregullorja ne fjale perdor terminologjine “where applicable” perpara kushtit qe do te thote se e le fleksibel ne per tu gjykuar rast pas rasti ne varesi te kushteve te produktit (nese ka pasur me pare historik certifikimi, kur skema e kerkon nje gje te tille, apo kur informacioni shton vlere sigurise kibernetike)	DPA	Pranuar	
Neni 15 “Rishikimi i certifikates”	- Pika 2, germa c) te riformulohet: “.....si dhe te leshoje nje certifikate te re me fushe identike dhe periudhe vlefshmerie te zgjatur”. Sqarim: te zevendesohet fjala “shtrirje” me fjalen “fushe”. - Germa ç) te riformulohet duke perdorur ne vend te togfjaleshit “qellim tjeter”, “fushe te ndryshme”	DPA	Pranuar	

Neni 17 “Kriteret dhe metodat e vlerësimit”	- Pika 1, germa b) te zevendesohet togfjaleshi “perdorimin e synuar” me “qellimin e perdorimit”. PS: eshte perdorur edhe ne vende te tjera gjate projekt aktit. Mendoj se formulimi i ri i pershtatet me shume kontekstit te projektaktit.	DPA	Pranuar	
Neni 18	sugjeroj te hiqet togfjaleshi “ne nje forme te plote dhe te sakte”, rregullorja	DPA	Pranuar	
Neni 19, “Lëshimi i certifikatave për profilet e mbrojtjes” (jo)	- Pika 4, germa a) te riformulohet “autoriteti kombetar certifikues i sigurise kibernetike i akredituar si trupe certifikuese, ose”	DPA	Pranuar	
Neni 21. “Rishikimi I nje certificate per profilet e mbrojtjes”	Ne menyre identike te reflektohen ndryshimet sikur jane dhene per nenin 15.	DPA	Pranuar	

Neni 24 “Kerkesa specifike shtese per nje organ certifikues”	- Pika 3 duhet riformuluar duke pasqyruar ate percaktim sic e ka dhene rregullorja si vijon: “Autoriteti kombëtar i certifikimit të sigurisë kibernetike harton një raport autorizimi, i cili i nënshtrohet <i>rishikimit ndërinstitucional/ vleresimit te ndersjellte nga homologet.</i> <i>Ne rastin e Shqiperise e cila nuk eshte anetare e BE “vlersimi I ndersjellte” do te mund te realizohet vetem nese ka nje marreveshje te njohjes se ndesjellte/reciproke dhe deshiron te behet pjese e skemes se vlersimit te ndersjellte!!!</i> Pika 6, duhet te riformulohet: <i>“per qellime autorizimi në rastin e degëve të organizmave europianë të notifikuar, që duan të operojnë në Shqipëri, si organe certifikuese te autorizuar per certifikimin e sigurise kibernetike, ato duhet të jenë te akredituar nga një organ akreditimi i një shteti anëtar të BE-së dhe anëtar i Organizatës Europiane të Akreditimit. Në këtë rast “Certifikata e akreditimit” te ketyre trupave duhet të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e këtij organizmi në territorin shqiptar për fushën përkatëse”.</i>	DPA	Refuzuar	Neni 24 është hartuar në përputhje me percaktime të rregullores zbatuese të Komisionit Evropian Nr. 2024/482 te ndryshuar.
Neni 25, “Kerkesa shtese ose specifike per nje ITSEF”	Ne menyre te ngjashme te reflektohen ndryshimet dhe sugjerimet sikur jane dhene ne Nenin 24, per perkatesisht per pikat 4 dhe 7 te nenit.	DPA	Refuzuar	Neni 25 është hartuar në përputhje me rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian Nr. 2024/482 te ndryshuar.

Neni 26 “Organi kombetar i certifikimit te sigurise kibernetike”	Pika 4, germa b) nuk eshte shume e kuptueshme se cfare do te thote “zbaton detyrimet e prodhuesve ose ofuesve te produkteve, sherbimeve,,,,,etj”?	DPA	Pranuar	
Neni 30	- A do te parashikohet ndonje gje ne lidhje me njoftimin e ENISA mbi pezullimin e certifikatave pas berjes shtet antarar i BE?	DPA	Refuzuar	Projektakti rregullon skemën kombëtare të certifikimit në kuadrin aktual institucional dhe ligjor. Çdo detyrim për njoftim ndaj ENISA-s do të rrjedhë drejtpërdrejt nga kuadri ligjor evropian pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe nuk është e nevojshme të parashikohet në mënyrë të posaçme

				në këtë fazë.
Neni 37, “Raporti i analizës së ndikimit të vulnerabilitetit	” pika 5, 6 dhe 7 ku permendet togfjaleshi “vulnerabiliteti nuk eshte i mbetur” apo “vulnerabilitet i mbetur” te zevendesohet perkatesisht me “cenueshmeria nuk eshte e tolerueshme”, “cenueshmeri e patolerueshme”	DPA	Refuzuar	Terminologjia “vulnerabilitet” dhe “vulnerabilitet i mbetur” është përdorur në përputhje me përcaktimet dhe terminologjinë e parashikuar në ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”,
Ne kapitullin IX “VLERËSIM I OPOENCËS SË ORGANEVE CERTIFIKUESE”,	Ne kapitullin IX “VLERËSIM I OPOENCËS SË ORGANEVE CERTIFIKUESE”, permendet ne shume dispozita terminologjia “vleresim i oponences”. Sugjeroj qe kjo terminologji te zevendesohet me “Vleresim i ndersjellte”.	DPA	Refuzuar	Eshte ruajtur e njejta linje me ate te BE.